



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

KORÇË MË ___/___/2023

RELACION

‘PËRFILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË OBJEKTIT ME SIPËRFAQE TOTALE PREJ 390 M2, PJESË E PASURISË ME NR.4/167 VOL.42, FQ.57. ZK 8564, NË ISH UMB KORÇË, SIPAS GENPLANIT BASHKËLIDHUR’

Bashkia Korçë ka në pronësi pasurinë me nr.4/167, vol.42 fq.57 me sipërfaqe 692.50 m2 truall dhe ndërtesë.

Një pjesë e kësaj pasurie, konkretisht 225 m2 sipërfaqe ndërtesë, i është dhënë me qira subjektit Skendian Larti me NUIS: K33810019L, me kontratë datë 15.06.2022 nr.5407 Prot, për një afat 1 vjeçar, deri më 14.06.2023.

Bashkia Korçë, me qëllim realizimin e funksioneve të saj në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, propozon fillimin e procedurave të dhënies me qira të objektit me sipërfaqe 390 m2 pjese e pasurise nr.4/167 ZK 8564.

Në referim të Kreut III të VKM nr.54 datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, **“tarifa dysheme në fuqi e qirasë mujore për ndërtesat në qarkun e Korçës është 150 lek / m2.**

Me qëllim vazhdimin e shfrytëzimit të këtij objekti në pronësi publike të Bashkisë Korçë, dhe me misionin e një menaxhimi sa më eficient të aseteve të saj, i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë fillimin e procedurave për dhënien me qira të kësaj sipërfaqeje ndërtimi, me tarifën dysheme në fuqi të qirasë mujore për ndërtesat në qarkun e Korçë prej 150 lek/m2, për një afat kohor prej 1 (një) vit, sipas genplanit bashkëlidhur këtij relacioni.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) “njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj” dhe c) “e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës” dhe pika 1.6 gërma a) “e drejta e lidhjes së kontratës”si dhe gërma e) “Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Bazuar në VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 date 05.02.2014”i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë fillimin e procedurave për dhënien me qira të objektit me sipërfaqe totale prej 390 m2, pjesë e pasurisë me nr.4/167 vol.42, fq.57. zk 8564, në ish UMB Korçë, për një afat 1 (një) vjeçar, me tarifën dysHEME në fuqi të qirasë mujore për ndërtesat në qarkun e Korçës prej 150 lek/m2, sipas genplanit bashkangjitur.

Drejtores e Përgjithshme
Anxhela DishnicaQeramixhiZhaneta Lubonja

Drejtores e DPKZHT

KRYETARI

Sotiraq FILO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

P/VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2023

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË OBJEKTIT ME
SIPËRFAQE TOTALE PREJ 390 M2, PJESE E PASURISE ME NR.4/167 VOL.42,
FQ.57. ZK 8564, NË ISH UMB KORÇË, SIPAS GENPLANIT BASHKËLIDHUR”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 54 gërma e) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 date 05.02.2014”, si dhe në VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për dhënie me qira të objektit me sipërfaqe totale prej 390 m2, pjesë e pasurisë me nr.4/167 vol.42, fq.57. zk 8564, në ish UMB Korçë, për një afat 1 (një) vjeçar, me tarifën dysheme në fuqi të qirasë mujore për ndërtesat në qarkun e Korçës prej 150 lek/m2, sipas genplanit bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike(*sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”*).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Ana VERUSHI

Miraturar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

K R Y E T A R